

LIGJ
Nr.9685, datë 26.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9267,
DATË 29.7.2004 “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT, TË RISIGURIMIT
DHE NDËRMJETËSIMIT NË SIGURIME DHE RISIGURIME”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 3 e nenit 72 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj paraqet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare një kopje të raportit vjetor të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar brenda 8 ditëve nga data e marrjes, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës. Nëse shoqëria e sigurimit përgatit llogari të konsoliduara ose zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera, ky raport paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës.”.

Neni 2

Neni 98 “Fondi i garancisë” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98
Fondi i garancisë

1. Fondi i garancisë së shoqërisë së sigurimit është i barabartë me 1/3 e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi, brenda klasave të sigurimit të jo jetës, nuk mund të jetë më i ulët se kufijtë minimalë të mëposhtëm:

a) 370 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 10, 11, 12, 13 e 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

b) 260 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16 e 18, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

c) 185 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 9 e 17, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

ç) 615 milionë lekë, nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit;

d) 370 milionë lekë, nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, për secilin nga tri vitet e fundit të veprimtarisë, nuk tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit.

3. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi, brenda klasave të sigurimit të jetës, nuk mund të jetë më i ulët se kufiri minimal prej 370 milionë lekësh, në

fillim të veprimtarisë, nëse shoqëria ushtron veprimtari për sigurimin e jetës në klasat 19, 20, 21, 22 e 23, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji.

4. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie risigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 615 milionë lekë.

5. Kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë, që mbulon rreziqet e disa klasave të sigurimit të jo jetës, duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë së klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë.

6. Fondi i garancisë depozitohet në një llogari bankare qëllimore, me të njëjtin emër, në njërin nga bankat, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, atje ku shoqëria ka selinë qendrore të saj.

7. Fondi i garancisë investohet vetëm brenda sistemit bankar në bono thesari dhe depozita, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit.

8. Administrimi dhe rastet e ndërhyrjes në fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 98 shtohet neni 98/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 98/1

Për shoqëritë e sigurimit, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi i garancisë, i parashikuar në nenin 98 të këtij ligji, do të jetë në nivelet e mëposhtme:

a) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 10, 11, 12, 13 e 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

i) 185 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;

ii) 270 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;

iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

b) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16 e 18, sipas; klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

i) 130 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;

ii) 190 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;

iii) 260 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

c) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 9 e 17, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

i) 90 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;

ii) 135 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;

iii) 185 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

ç) nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit:

i) 370 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;

ii) 500 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;

iii) 615 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

d) nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, për secilin nga tri vitet e fundit të veprimtarisë, nuk tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit:

i) 185 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;

ii) 270 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;

iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

dh) nëse shoqëria ushtron veprimtari për sigurimin e jetës në klasat 19, 20, 21, 22 e 23, sipas

klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

- i) 220 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 300 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;
- e) nëse shoqëria ushtron veprimtarinë e risigurimit:
 - i) 370 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
 - ii) 500 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
 - iii) 615 milionë lekë deri më 31 mars 2008.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5217, datë 13.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**